

URDHËR
Nr. 175, datë 8.5.2013

PËR HAPJEN E INSTITUTIT TË FIZIKËS BËRTHAMORE TË ZBATUAR NË
UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 8, 10, 14, si dhe të pikave 5 dhe 6 të nenit 41 dhe pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës të Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, si njësi kryesore.
 2. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar, të ketë në përbërje këto njësi bazë:
 - a) Departamenti i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe Rrjeteve të Monitorimit;
 - b) Departamenti i Radiometrisë e Radiokimisë;
 - c) Departamenti i Metodave Analitike Instrumentale.
 3. Struktura e Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe rregulloret e Universitetit të Tiranës.
 4. Efektet financiare për zbatimin e këtij urdhri përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.
 5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Universiteti i Tiranës, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj